

STATUTI

I


SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI

TË KUFIZUAR

THE A

Sh.p.k.

17 Qershor 2021



Bazuar në ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", dhe ligjit 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", unë e nënshkruara shpall si më poshtë vijon:

Kreu I

Emri, Ortakët, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia

Neni 1 – Emri dhe Ortakët

1.1 Emërtimi i Shoqërisë është "THE A" Sh.p.k.

1.2 Ortaket e Shoqërisë janë :

- 1 **Znj. Aline Hauck**, lindur ne Erlangen (Gjermani) me 21.10.1987, shtetase Gjermane, banuese ne Rruga "Baftjar Lici", Pall 34, H. 1, Kati 2, Ap. 4, Tirane, titulare e pasaportes nr. C6ZZGYN9K, leshuar me date 24.07.2014 e cila zotëron një kuotë të barabartë me 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 2 – Objekti

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Zhvillimi dhe kryerja e veprimtarise se sherbimeve te ndryshme, restorant & bar.

Lloji i biznesit perfshin gjithashtu apartamente me qira, akomodim si dhe nje dyqan ne ndertesën ku mysafiret mund te blejne produkte shqiptare.

Cdo veprim tjeter financiar e tregtar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e veprimtarise dhe qe eshte ne perputhje me objektin e veprimtarise dhe qe eshte ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Çdo lloj aktiviteti i lejuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është me nje kohe te pacaktuar, kohëzgjatje e cila mund të shtyhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4 – Selia

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga "Baftjar Lici", Pall 34, H. 1, Kati 2, Ap. 4, Tirane, Shqiperi.

Kreu II

Kapitali i Regjistruar

Neni 5 – Vlera e kapitalit të regjistruar

5.1 Kapitali fillestar i Shoqërisë është 25,000 EUR (njëzete e pese mije), Kapitali themeltar shlyhet nga themeluesi.

5.2 Ortaku themelues do të zotërojne kapitalin themeltar të shoqërisë si më poshtë:

- Znj. Aline Hauck, lindur ne Erlangen (Gjermani) me 21.10.1987, shtetase Gjermane, banuese ne Rruga "Baftjar Lici", Pall 34, H. 1, Kati 2, Ap. 4, Tirane, titulare e

pasaportes nr. C6ZZGYN9K, leshuar me date 24.07.2014.

Neni 6 – Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve te pjesëve të Kapitalit Themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë me kërkesë të ortakut ose Asamblese se Ortakëve.
- 6.2 Asambleja e Ortakëve, me shumicë të kualifikuar votave të ortakëve që përfaqësojnë 75% të kapitalit themeltar të shoqërisë, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur vlerën nominale të kuotave të ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të kuotave të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, por ata janë të lirë të heqin dorë nga kjo e drejtë. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në Shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve që përfaqësojnë 75% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- 6.3 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Ortakëve, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve që përfaqësojnë 75% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 7 – Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve

Në përputhje me dispozitat të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Ortakëve, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve që përfaqësojnë 75% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 8 – Certifikatat e kuotave

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare". Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 9 – Kalimi me Kontratë i Kuotave

- 9.1 Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kuotat e kapitalit themeltar mund t'u tranferohen lirisht personave të tretë me vendimin e Asamblesë së Ortakëve të marrë me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve që përfaqësojnë 75% të kapitalit themeltar të shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë kuotën e tij tek të tretët, duhet të njoftojë ortakët e tjerë, duke i dërguar një njoftim postar në adresën

- e banimit të tyre, si dhe Shoqërisë duke i dërguar njoftim postar Administratorit/ve në adresën e Kryetarit. Në rast se Administratori/et nuk e thërret Asamblenë, ose Asambleja nuk merr vendim për shitjen brenda tre muajve nga data e njoftimit të fundit nga ana e ortakut propozues, ky i fundit mund të shesë lirisht kuotat e zotëruara prej tij në kapitalin themeltar.
- 9.2 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratori/et. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e Shoqërisë.
- 9.3 Administoret mund të refuzojë regjistrimin e kalimit të kuotës në regjistrin tregtar në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se Asambleja e Ortakëve nuk është dakord me personin të cilit i kalon kuota.
- 9.4 Nëse Administori/et refuzon/jne të regjistrojë kalimin e kuotës, ky do të njoftojë për mospranimin personin të cilit i kalohet kuota, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në Shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.
- 9.5 Në rast se propozimi për shitje nuk miratohet nga Asambleja e Ortakëve, kuotat e ofruara për shitje duhet të blihen nga ortakët që kanë kundërshtuar shitjen ose këta të fundit duhet të gjejnë një blerës të pranueshëm brenda 3 (tre) muajve, për një çmim të caktuar nga një ekspert kontabël, në përputhje me Ligjin.

Neni 10 – Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- 10.1 Nëse një ortak vdes trashëgimtarët e tij do të jenë personat e vetëm të njohur nga Shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij. Pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 10.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori/et, mund të zgjedhë/in të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër, pasi ta ketë ofruar atë më parë me të njëjtat kushte për ortakët të tjerë të Shoqërisë.
- 10.3 Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Ortakëve, deri në momentin e regjistrimit në regjistrin tregtar.

Kreu III

Asambleja e Ortakëve

Neni 11– Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

- 11.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë. Administratori/ët thërrasin Asamblesën e Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakëve sipas nenit 84 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", do të procedojnë me thirrjen e Asamblesës së Ortakëve.
- 11.2 Mbledhja e Asamblesës së Ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*email*) drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesës së Ortakëve i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga shumica e ortakëve të cilët zotërojnë jo më pak se nëntëdhjetë për qind të vlerës nominale të kuotave. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.
- 11.3 Mbledhjet e Asamblesës së Ortakëve janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme së njoftimit apo mos-marrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

Neni 12 – Mbledhjet e Asamblesës së Ortakëve

- 12.1 Asambleja e Ortakëve merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 Ligji 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare". Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare". Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesës së Ortakëve.
- 12.2 Administratori/ët cakton/jnë Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
- 12.3 Nëse asnjë prej Ortakëve të Asamblese ose Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- 12.4 Administratori/ët, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesës së Përgjithshme.
- 12.5 Kryetari, me pëlqimin e Asamblesës së Ortakëve të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesës së Ortakëve, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesës së Ortakëve shtyhet të paktën katërmbëdhjetë ditë, njoftimi

- do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Ne rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.
- 12.6 Asambleja e Ortakeve vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:
1. Kryetari; ose
 2. një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortakut.
- 12.7 Me përjashtim të kundërshtimit të një ortakut, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
- 12.8 Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 13 – Votat e Ortakëve

- 13.1 Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (ne rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
- 13.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Ortakeve, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.
- 13.3 Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

Neni 14 – Votimi me Prokurë

- 14.1 Përfaqësuesi do të emërohet nga ortakut sipas formës që mund të miratohet nga Administratori/ Administratorët.
- 14.2 Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo i miratuar nga Administratorët depozitohet në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 15 – Vendimet e Asamblesë së Ortakëve

- 15.1 Asambleja është e zakonshme ose e jashtëzakonshme në varësi të vendimeve për të cilat thirret që të marrë vendim.
- 15.2 Asambleja e zakonshme vendos me votën në favor të shumicës së votave të ortakëve që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit themeltar të Shoqërisë për çështje të tilla si:
- a. miratimin e politikave/projekteve për shtrirjen, zmadhimin/zvogëlimin e aktivitetit dhe të investimeve të nevojshme;
 - b. miratimin e politikës së personelit, ku përfshihen miratimi i strukturës, emërimi/shkarkimi i personelit, pagat;
 - c. miratimi i rregullores së funksionimit të brendshëm;
 - d. emërimi/shkarkimi i Administratorit të Vetëm ose Administratoreve, ekspertëve kontabël të aurorizuar dhe likuidatorëve;
 - e. përcaktimi i pagës dhe shpërblimeve të Administratorit të Vetëm ose Administratorevë;
 - f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore, rezervave dhe shpërndarjes së fitimit.
- 15.3 Asambleja e jashtëzakonshme vendos me votën në favor të shumicës së votave të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% të kapitalit themeltar të Shoqërisë për çështje të tilla si:
- a. ndryshimin e Statutit;
 - b. zvogëlimin/zmadhimin e kapitalit themeltar;
 - c. zgjatjen e kohës së veprimtarisë Shoqërisë ose likuidimin e saj;
 - d. shndërrimin e Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në një formë tjetër;
 - e. çdo çështje tjetër që Ligji parashikon.

**Kreu IV
Administratorët****Neni 16 – Emërimi i Administratorit/ve**

- 16.1 Asambleja e Ortakëve zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare". Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Ortakëve, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
- 16.2 Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".
- 16.3 Personi e mëposhtëm caktohen si Administrator ortaku i vetem me afat 5 (pesë) vjeçar:

1. **Znj. Aline Hauck**, lindur ne Erlangen (Gjermani) me 21.10.1987, shtetase Gjermane, banuese ne Rruga "Baftjar Lici", Pall 34, H. 1, Kati 2, Ap. 4, Tirane, titulare e pasaportes nr. C6ZZGYN9K, leshuar me date 24.07.2014.

Neni 17 – Kompetencat e Administratorit/ëve

- 17.1 Shoqëria do të administrohet nga Administratori/ët të cilët mund të ushtrojnë pa kufizim dhe/ose veçmas të gjitha ato kompetenca që nuk i rezervohen Asamblesë së Ortakëve sipas nenit 81 të Ligjit Ligji 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

Kreu V

Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 18 – Dividendët

Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare". Asambleja e Ortakëve me votën ne favor të shumicës së votave të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% të kapitalit themeltar të Shoqërisë mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Neni 19 – Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratori/ët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Ortakëve me votën ne favor të shumicës së votave të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% të kapitalit themeltar të Shoqërisë dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Kreu VI

Prishja dhe njoftimet

Neni 20 – Prishja dhe likuidimi

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë nga Asambleja e Ortakëve me votën ne favor të shumicës së votave të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

Neni 21– Njoftimet


- 21.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

21.2 Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike që i është njoftuar shoqërisë nga ortakut.

Statuti pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe pavërejtje është hartuar në 3(tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtë ligjore dhe u nënskrua prej tij rregullisht me date 17 Qershor 2021.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut te Vetem:

- Znj. Aline Hauck:

Aline Hauck 
(emër, mbiemër, firmë)